

Raport Vjetor
Grupi për Persona të Zhdukur

Korrik 2019

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Përparimi i arritur (Nëntor 2018 - Korrik 2019).....	3
Aktivitetet për të zgjidhur rastete paidentifikuara ose NN në territorin e ish Jugosllavisë.....	4
Shkëmbimi i të dhënave për rastet e personave të zhdukur ndërmjet IV-ve duke përdorur “Bazën e të dhënave të rasteve aktive të personave të zhdukur nga territori i ish Jugosllavisë” në vitet 1990 ..	Error!
Bookmark not defined.	
Shkëmbimi i informacioneve në lidhje me vendvarrezat e jashtligjshme potenciale dhe ndërmarrja e gërmimeve të përbashkëta.....	Error! Bookmark not defined.
Angazhimi i famlijeve të personave të zhdukur në proces.....	6
Aktivitetet tjera relevante.....	6
Konkluzionet.....	7

Hyrje

1. Në Samitin e Pestë të Procesit të Berlinit në Londër në korrik 2018, liderët e 14 vendeve pjesëmarrëse në Procesin e Berlinit (Shqipëria, Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Franca, Kroacia, Italia, Kosova, Gjermania, Maqedonia Veriore, Sllovenia, Serbia, Polonia dhe Mbretëria e Bashkuar) nënshkruan një Deklaratë të Përbashkët që konfirmon rëndësinë e gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur gjatë konflikteve të viteve 1990 në territorin e ish-Jugosllavisë dhe nevojës për përpjekje më intensive për të gjetur dhe / ose identifikuar rreth 12,000 raste të pazgjidhura, veçanërisht nëpërmjet përmirsimit të bashkëpunimit shumëpalësh dhe punës së përbashkët. Pjesëmarrësit në Procesin e Berlinit në Deklaratë përsëritën rëndësinë e hetimeve të paanëshme dhe efektive të rasteve të personave të zhdukur në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke siguruar pjesëmarrjen aktive të familjeve të të zhdukurve dhe përmbajtjen nga të gjitha format e politizimit të çështjeve të personave të zhdukur. Deklarata e përbashkët mbështetet në parimet e praktikave më të mira, të theksuara në *Deklaratën mbi rolin e shtetit në zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur për shkak të konflikteve të armatosura dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut të nënshkruara në 2014 nga presidentët e Bosnje dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Kroacisë dhe Sërbisë.*

Përparimi (nëntor 2018 – korrik 2019)

2. Më 6 nëntor 2018, në selinë e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (në tekstin e mëtejshëm: ICMP) në Hagë, përfaqësuesit e institucioneve vendore që janë përgjegjëse për llogaridhënjen për personat e zhdukur (IV) në Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi, Kroaci, Kosovë dhe Serbi¹, duke u përpjekur të rrisin efektivitetin në llogaridhënjen për personat e zhdukur, nënshkruan një Plan Kornizë për të adresuar çështjen e personave të zhdukur nga konfliktet në territorin e ish Jugosllavisë (Plani Kornizë), me qëllim të rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit shumëpalësh.
3. Për të kontribuar më tej në zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur, Republika e Kroacisë, si anëtare e plotë e Bashkimit Evropian, ka mbështetur zbatimin e Planit Kornizë duke marrë pjesë në punën e Grupit të Personave të Zhdukur.
4. Me nënshkrimin e Planit Kornizë, institucionet vendore **themeluan Grupin për Persona të Zhdukur** (në tekstin e mëtejshëm: GPZH), që përbëhet nga përfaqësues të institucioneve vendore nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Anëtarët e GPZH-së ranë dakord të punojnë bashkërisht për çështjet e mëposhtme:
 - zgjidhja e rasteve të paidentifikuara ose të NN (nomen nescio/pa emër) në territorin e ish-Jugosllavisë;

¹ Marredhenjet ndërmjet Institucioneve vendore të Kosovës dhe Serbisë nuk janë të rregulluara me marrëveshje dypalëshe ose protokolle, por ato mbahen përmes mekanizmit ekzistues të Grupit Punues për personat e zhdukur në lidhje me ngjarjet në Kosovë, në kuadër të dialogut Bograd – Prishtinë, gje që është në linjë me Nenin 1 të Planit Kornizë

- shkëmbimi i të dhënave për rastet e personave të zhdukur në mes të institucioneve vendore dhe familjeve të të zhdukurve me anë të "bazës së të dhënave të rasteve aktive të personave të zhdukur nga konfliktet në territorin e ish-Jugosllavisë;
 - shkëmbimi i informacionit mbi vendet e mundshme të varrezave klandestine, dhe ndërmarrja e gërmimeve të përbashkëta;
 - angazhimi i familjeve të të zhdukurve në proces; dhe
 - organizimi i përkujtimeve të përbashkëta për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve.
5. ICMP, me mbështetjen financiare të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, ofroi asistencë teknike dhe ndihmoj punën e institucioneve vendore në zbatimin e Planit Kornizë.

Aktivitetet për zgjidhjen e rasteve të paidentifikuara ose NN në territorin e ish-Jugosllavisë

6. GPZH-ja më 4 dhjetor 2018 themeloi një **Grup Operacional për të zgjidhur rastet paemër NN** ose rastet e paidentifikuara (në tekstin e mëtejshëm: GONN)². Intitucionet vendore në janar 2019 propozuan stafin e tyre, ekspertët e mjekësisë ligjore dhe ekspertët e tjerë në GONN. Qëllimi i GONN është që përmes shkëmbimit të përvojave, së bashku, të zhvillojnë projekte pilot të kufizuara dhe të synuara që do të ndihmojnë institucionet vendore për të ndërmarrë hapa shtesë për të zgjidhur rastet NN.
7. Deri më sot, anëtarët e GONN kanë shkëmbyer informacione të hollësishme rreth përpjekjeve të tyre individuale për të trajtuar çështjen e rasteve NN në territoret e tyre. Duke pranuar specifikat e secilës prej institucioneve vendore që marrin pjesë në GONN si dhe ngjashmëritë në vetë problemin që punojnë për ta zgjidhur, anëtarët e GONN ranë dakord që së bashku të **shqyrtojnë rastet NN që vinin nga një numër i kufizuar vendesh** në territoret e anëtarëve të GPZH. Përveç kësaj, anëtarët e GONN kanë caktuar raste specifike me interes të përbashkët për punë të mëtejshme.
8. GPZH është i bindur se duke shkëmbyer përvojat në përpjekjet e deritanishme dhe duke shqyrtuar së bashku rastet e nominuara NN, ekspertët do të jenë në gjendje të përcaktojnë hapat e ardhshëm në zgjidhjen e rasteve NN.

²Janë më shumë se 3,000 raste të paidentifikuara (në tekstin e mëtejshëm: pa emër- NN) të ruajtura në morgje në BIH, rreth 900 në Kroaci, 400 në Kosovë dhe rreth 190 të varrosur në parcelat komunale në Serbi. Rastet NN konsiderohen raste që nuk mund të identifikoheshin në bazë të analizës së ADN-së ose me metoda klasike të identifikimit të aplikuara përpara se të përdoret analiza e ADN-së ose kanë mbetur të paidentifikuara për arsye të tjera, p.sh. rastet historike që nuk dalin nga konfliktet e kohëve të fundit. Institucionet vendaore, anëtarët e GPZH, tashmë kanë ndërmarrë aktivitete për të zgjidhur këtë problem, por ai ende mbetet e pranishme.

Aktivitetet në shkëmbimin e të dhënave për rastet e personave të zhdukur në mes të IV-ve dhe familjeve të të zhdukurve me anë të "Baza e të Dhenave të Rasteve Aktive të Personave të Zhdukur nga Konfliktet në Territorin e ish-Jugosllavisë" në vitet 1990

9. Çdo institucion vendor mban, mirëmban dhe organizon të dhënat e veta për personat e zhdukur që përfaqësojnë burimin zyrtar të informacionit rreth personave të zhdukur. Të dhënat zyrtare mbeten në jurisdiksonin e institucioneve të cilat i kanë mbirëmbajtur ato më parë. Duke pasur parasysh natyrën e konfliktit dhe lëvizjen masive të njerëzve, është bërë e nevojshme që të konsolidohen, krahasohen dhe harmonizohen regjistrimet individuale në një bazë të dhënash të vetme. Një bazë unike interaktive e të dhënave për rastet e personave të zhdukur është një mjet në formën e një platforme pune përmes së cilës institucionet vendore mund të rishikojnë, verifikojnë dhe koordinojnë rastet e personave të zhdukur që janë objekt i interesit të një institucioni vendor apo tjetri, duke siguruar disponueshmëri të vazhdueshme, të dhëna të besueshme dhe të azhurnuara për përdoruesit profesionistë dhe partnerë të tjerë në këtë proces. Një bazë e tillë gjithashtu do t'u mundësonte familjeve të të zhdukurve dhe pjesëtarëve të tjerë të publikut që të shikojnë dhe të shqyrtojnë të dhënat ekzistuese në të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë si dhe mundësinë online për të dhënë komente dhe komente për institucionet vendore.
10. **Baza e të dhënave të rasteve aktive të personave të zhdukur në konfliktet në ish-Jugosllavi** u zhvillua pas shkëmbimit zyrtar të letrave dhe marrëveshjeve të nënshkruara, ndërmjet ICMP dhe institucioneve vendore gjatë viteve 2016 dhe 2017. Burimi i të dhënave për të zhdukurit në lidhje me konfliktin në Kosovë është duke u negociuar. ICMP ka zhvilluar për përdoruesin një softuer të bazës së të dhënave që përfshin të dhëna të ofruara nga institucionet vendore. Rezultati i këtyre aktiviteteve është baza e të dhënave e të gjitha rasteve aktive të personave të zhdukur nga ish-Jugosllavia.
11. Nga janari deri në qershor të vitit 2019, **institucionet vendore kanë bërë 445 të hyra në bazën e të dhënave**, duke përfshirë informacionin mbi statusin e rasteve në vendet e tyre dhe harmonizimin e të dhënave për personat e zhdukur.
12. Në peridhën vijuese, anëtarët e Grupit Operativ për Bazën e të Dhënave do të vazhdojnë punën në harmonizimin dhe përditësimin e të dhënave dhe të mbyllin rastet aktive të personave të zhdukur, me synimin për të lansuar një version të bazës së të dhënave që do të jetë i qasshëm për publikun.

Veprimet për shkëmbimin e informacioneve mbi vendet e mundshme të varrezave të paligjshme, varrezave ku gjenden mbetjet e paidentifikuara (NN) dhe ndërmarrja e zhvarrimeve të përbashkëta

13. Gjatë kësaj periudhe raportuese, **anëtarët e GPZH diskutuan mundësitë për shkëmbimin e informacionit** mbi vendet e mundshme të interesit të përbashkët ku një varrezë e mundshme mund të gjendet në një vend, ndërsa të afërmit jetojnë në një tjetër.

14. Në këtë kontekst, të gjitha institucionet vendore kanë shprehur gatishmërinë për të kryer hulumtime në terren dhe, në përputhje me gjetjet, zhvarrimin e mbetjeve mortore. Në takimet nën kuadër të Planit Kornizë, në takimet dy-palëshe dhe përmes mekanizmave të tjerë ekzistues, institucionet vendore propozuan 16 vende konkrete për të punuar në periudhën në vijim.
15. Gërmimet e vendeve me interes të përbashkët do të kryhen në përputhje me marrëveshjet ekzistuese dypalëshe dhe ndërkombëtare dhe mekanizmat ekzistues të bashkëpunimit, duke ofruar një mundësi për monitorimin e ekspertëve nga palët e interesuara gjatë gjetjes së varrezave potenciale, kryerjes së hetimeve në terren dhe zhvarrosjes së mbetjeve njerëzore, me ftesë të institucioneve vendore përgjegjëse për territorin ku po zhvillohen këto aktivitete. Kjo do të kontribuonte në nxitjen e partneritetit profesional ndërmjet institucioneve vendore, nënshkruesve të Planit Kornizë, ndërkohë që rezultatet e mira do të rrisin besimin e publikut në kredibilitetin e përpjekjeve.
16. Informacioni më i fundit mbi progresin në adresimin e rasteve të lartpërmendura, si dhe rastet e reja të mundshme, do të përfshihen në Raportin Vjetor të ardhshëm të GPZH-së.

Angazhimi i familjeve të të zhdukurve në proces

17. Për të siguruar informacion të saktë dhe të përditësuar për familjet e të zhdukurve **GPZH ka bërë një angazhim për të marrë pjesë në një sërë takimesh për ndarjen e informatave me familjet**. Familjet do të informohen për progresin që është bërë në kuadër të Planit të Përbashkët Kornizë dhe çështje të tjera aktuale që lidhen me personat e zhdukur. **ICMP në Janar 2019 në Bosnjë dhe Hercegovinë ka organizuar një takim të tillë** dhe mblodhi së bashku përfaqësues të institucioneve dhe ekspertëve të përfshirë në zgjidhjen e çështjeve të personave të zhdukur.
18. Takime të tilla ofrojnë një platformë për shkëmbimin e informacionit dhe kështu të rrisin transparencën e procesit dhe besimin e familjeve të personave të zhdukur dhe palëve të tjera të interesuara në veprimet e IV.
19. Gjatë periudhës raportuese, përfaqësues të koordinimit rajonal të familjeve të personave të zhdukur nga konfliktet në ish-Jugosllavi (në tekstin e mëtejshëm: KR) kanë mbajtur takime me të gjitha institucionet vendore, nënshkruesit e Planit Kornizë, në të cilat kanë marrë informacion në lidhje me aktivitetet dhe rezultatet e arritura në 7 muajt e fundit, në mënyrë që familjet, anëtarët e KR të jenë të informuar për progresin në zbatimin e Planit Kornizë.

Aktivitetet tjera relevante

20. Gjatë kësaj periudhe raportuese, institucionet vendore zhvilluan një sërë takimesh bilaterale dhe aktivitete të tjera në kuadër të mekanizmave ekzistues:
 - Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi finalizuan tekstin e Protokollit të bashkëpunimit në procesin e kërkimit të personave të zhdukur më 28 mars 2019. Qeveria e Malit të Zi ka miratuar

Protokollin, ndërsa Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës do ta bëjë këtë në të ardhmen, e cila do të pasohet me nënshkrimin e Protokollit.

- Institucionet vendore të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë u takuan më 17 prill 2019 për të diskutuar rregullat dhe procedurat për zbatimin e Protokollit për bashkëpunimin në procesin e zgjidhjes së qështjes së personave të zhdukur, i cili është aktualisht në fazën përfundimtare para miratimit të tij.
- Institucionet vendore të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe të Serbisë më 15 maj 2019 në Sarajevë kanë përcaktuar tekstin përfundimtar të rregullave dhe procedurave për zbatimin e Protokollit për bashkëpunimin në procesin e zgjidhjes së qështjes së personave të zhdukur midis Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës.
- Institucionet vendore të Kroacisë dhe të Serbisë mbajtën një takim me 29 maj në Vukovar lidhur me shkëmbimin e informacionit mbi vendndodhjet e varrezave primare dhe sekondare në Vukovar-Srijem dhe Osijek-qarkun e Baranjës në Kroaci.
- Institucionet vendore të Kosovës dhe Malit të Zi mbajtën një takim dypalësh me 6 qershor 2019 për të diskutuar një mori çështjesh, përfshirë edhe varrimin e personave të zhdukur në Kosovë të identifikuar si rezultat i perpjekjeve të kombinuara të IV-ve të Kosovës, Malit të Zi Serbisë dhe ICMP-se.
- ICMP-ja lehtësoi një takim të institucioneve vendore të Serbisë dhe të Kosovës më 23 maj 2019 në Prishtinë, me qëllim të shkëmbimit të informacionit në lidhje me rastet NN dhe të dakordohen për hapat për zgjidhjen e tyre.

21. Lidhur me **riatdhesimin e mbetjeve mortore të identifikuara**, gjatë periudhës raportuese IV-re zbatuan aktivitetet e mëposhtme:

- Institucioni vendor i Kroacisë riatdhesoi mbetjet mortore të një personi tek institucioni vendor i Bosnjës dhe Hercegovinës;
- Institucioni vendor i Kroacisë riatdhesoi mbetjet mortore të një personi tek institucioni vendor i Serbisë.
- Më 6 qershor 2019, në Podgoricë, institucionet vendore të Kosovës dhe të Malit të Zi ranë dakord që institucioni vendor i Kosovës do të riatdhesojë mbetjet mortore të pesë individëve në Mal të Zi, familja e të cilëve jetojnë në Malin e Zi.
- Institucioni vendor i Kosovës riatdhesoi mbetjet e pjeshme mortore të një individi tek institucioni vendor i Serbisë.
- Institucioni vendor i Serbisë riatdhesoi mbetjet e pjeshme mortore të një individi tek institucioni vendor i Bosnjës dhe Hercegovinës.

Konkluzionet

22. Institucionet vendore përgjegjëse për zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Mali të Zi dhe Serbi mbeten të angazhuar për të punuar së bashku përmes mekanizmit GPZH-së. Me punën e deritanishme, anëtarët e GPZH-së kanë rritur bashkëpunimin e ndërsjellë, e cila është reflektuar në shkëmbimin e informatave relevante për zgjidhjen e rasteve individuale NN, dhe ranë dakord të punojnë së bashku për të zgjidhur këto raste. Për më tepër, anëtarët e GPZH janë duke punuar intensivisht në krijimin e një baze të dhënash për rastet aktive të personave të zhdukur nga konfliktet në ish-Jugosllavi, si e vetmja bazë e të dhënave të këtij lloji në botë. Gjithashtu, anëtarët e GPZH kanë filluar një dialog për

shkëmbimin e informacionit mbi vendet me interes të përbashkët. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se anëtarët e të GPZH-së u takuan me familjet e të zhdukurve të mbledhur në Koordinimit Rajonal të familjeve të personave të zhdukur nga konfliktet në ish-Jugosllavi për të informuar ata në lidhje me progresin e bërë në kuadrin e Planit Kornizë të përbashkët. Takime të tilla janë planifikuar edhe në të ardhmen. Duke punuar së bashku për çështjet që janë të listuara në këtë raport është bashkëpunimi i përmirësuar në zgjidhjen e rasteve të personave të cilët janë ende duke u kërkuar dhe mund të sjellin ngushtë të familjeve të personave të zhdukur. Një punë e tillë forcon besimin mes institucioneve vendore dhe besueshmërinë e kredibilitetit të përpjekjeve që secili institucion ka investuar në gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur, duke ndihmuar, në këtë mënyrë, de-politizimin e çështjes së personave të zhdukur.

23. Ne, anëtarët e GPZH-së, duam të shprehim mirënjohjen ndaj Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për mbështetje të aktivitete të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur dhe ICMP për mbështetje organizative në zbatimin e Planit Kornizë.